

# Newspaper on the Rights of Persons with Disabilities of Kosovo



e-mail: newspwd@yahoo.com

011

**Revista e cila merret me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara**



Iniciatore për fillimin e botimit të kësaj gazete është Zyra Amerikane në Prishtinë.

"Ky projekt u financua përmes grantit të zyrës së SHBA-ve në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo mendoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit..."



"Ky numër është financuar nga granti i ndarë nga Fondi për Mbështetjen e Mediave Minoritare, Multietnike dhe të Grupeve Tjera të Pafavorizuara. Këtë fond e ka themeluar Qeveria e Kosovës."

**Mirë se erdhët në botën tonë**

Kjo gazetë joprofitabile botohet në pesë gjuhë: si shtojcë në gjuhën shqipe distribuohet përmes të përditshmes (Koha Ditore), në gjuhën boshnjake përmes (Alem), në serbishte (Jedinstvo) dhe gjuhës turke (Jeni Donem). Në këto gjuhë dhe versionin anglisht mund ta lexoni edhe përmes website [www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com) Bashkpunëtores vullnetare e redaksisë Diana Toska

## T'ju ndihmojmë personave me aftësi të kufizuara që ta jetojnë jetën e tyre pa pengesa

Respekti për dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut, liritë themelore, krijimi i kushteve dhe mundësive të barabarta për të gjithë, pa marrë parasysh aftësinë e kufizuar, moshën, racën, gjininë,



gjuhën apo religjionin, janë parime themelore që po na udhëheqin përgjatë procesit të ndërtimit dhe zhvillimit të institucioneve demokratike dhe funksionale.

Jeta pa pengesa është një prej parakushteve për plotësimin e barabartë të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Ndërtesat publike dhe mjetet e transportit publik, pajisjet e nevojshme teknike, sistemet e përpunimit të informacionit, burimet akustike dhe pamore të

informacionit, lehtësitë e komunikimit do të konsiderohen pa pengesa, nëse ato janë të arritshme dhe të shfrytëzueshme nga personat me aftësi të kufizuara në mënyrë të zakonshme.

Qeveria e Kosovës angazhohet të përmirësojë kushtet e jetesës dhe mirëqenies për personat me aftësi të kufizuara në fushën e arsimit, punësimit, ngritjes dhe aftësimeve profesionale, shërbimet e ndihmës sociale. Në këtë mënyrë, kapërcehet dallimi në mes personave me aftësi të kufizuar në shoqërinë tonë.

Kuadri ligjor që rregullon statusin shoqëror social dhe ekonomik, dhe që ka për qëllim të ofrojë garantimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara në shoqëri, është

duke u përmirësuar gradualisht. Kjo vjen si rezultat i angazhimit të qeverisë dhe ndikimit të vetë personave me aftësi të kufizuara si dhe të organizatave përfaqësuese të tyre

Kryeministri ka autorizuar themelimin e Këshillit Nacional për Personat me Aftësi të Kufizuara. Ky këshill përbëhet prej 16 anëtarëve dhe kryesohet nga zëvendëskryeministri. Në kuadër të Zyrës për Qeverisje të Mirë, është ngritur Sekretariati që do të ofrojë mbështetjen profesionale dhe organizative të aktiviteteve të këshillit.

Këshilli analizon rregullisht çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e njerëzve me aftësi të kufizuar dhe të drejtave të tyre; definojnë prioritetet dhe masat e nevojshme që duhen të ndërmerren nga Qeveria e Kosovës dhe shoqëria civile për përmirësimin e situatës së tanishme.

Investimi në fushën e të drejtave të njeriut paraqet një nga investimet me të rëndësishme dhe afatgjate që përbën edhe zotimin programor të Qeverisë së Kosovës. Më 21 korrik 2005, është nxjerr vendimi për themelimin e Njësisë për të Drejtat e Njeriut në secilën ministri. Këto njësi do të ofrojnë lehtësi për realizimin, gëzimin dhe raportimin permanent mbi gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, ndërsa me 11 gusht 2005, është nënshkruar Udhëzimin Administrativ Nr.8/2005 për përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësisë të Njësiteve për të Drejtat e Njeriut.

Këto dhe aksionet tjera që do të ndërmerr Qeveria e Kosovës, besojmë, se do të përmirësojnë pozitën dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

**Agim Çeku**  
Kryeministër i Kosovës

## CEREMONIA PERFUNDIMTARE E PROGRAMIT - DMD

KONVENTA SFIDE PER SHOQERIN KOSOVARE

Vijon ...

**KONVENTA**

**MUAJI I PUNËSIMIT**

**SPORTET**

**REHABILITIMIN PROFESIONAL**

# CEREMONIA PERFUNDIMTARE E PROGRAMIT - DMD

## KONVENTA SFIDE PER SHOQERIN KOSOVARE 99% TE PAPUNE- kategoria më e varfër e shoqërisë

Tani më tre vite me rradhë Zyra e Kryeministrit me iniciativ dhe në bashkëpunim me OJQ të e mbledhura rreth programit multi-etnik vullnetar DMD ( Ditët e mundësive profesionale të personave me aftësi të kufizuara), në një tryezë të rrumbullakët ftoi të gjithë faktorët relevant të Kosovës të marrin pjesë në ceremonin përfundimtare të Programit DMD e cila u mbajtë më 30 tetor të këtij viti. Gjatë tërë vitit DMD organizon katër fushata me qëllim të sensibilizimit të opinionit kosovar lidhur me çështjen e dinjitetit dhe integritetit të personave me aftësi të kufizuara, përpjekjeve në përmisimin e situates së rëndë të grave dhe fëmijëve dhe promovimin e mundësive profesionale të kësaj kategorie të qytetarëve.

Në tryezën e mbajtur në temën "Konventa mbi të drejtat e personave me



afhtësi të kufizuara, paraqitja e qëllimeve dhe diskutimi mbi masat e domosdoshme që duhet ndërmarë si shoqëri. Si të kyqen elemente nga Konventa në Legjislativin e Kosovës? ( amandmane apo ligj i ri?)". Me këtë rastë Drejtori nga Zyra e qeverisjes së mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, z. Habit Hajredini tha: "dëshirojmë të theksojmë se partneriteti me OJQ-të në programin multi-etnik vullnetar DMD është një praktikë e mirë për përgaditjen tonë në implementimin e qëllimeve nga Konventa mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara , e cila u miratua pas 5 vitesh diskutimi mes shteteve anëtare të KB, e të cilat u dakorduan për një marëveshje të re mbi të drejtat e kësaj kategorie të qytetarëve në mbarë botën. Në këtë proces të gjatë e të vështirë si dhe në përpilimin e tekstit, Kosova morri pjesë aktive. Duke marrë parasysh rëndësinë që ka kjo Konventë, duhet përgëzuar OJQ-në nga Kosova e cila afirmoi imazhin pozitiv të vendit tonë në këtë sferë, përkatësisht, në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në planin ndërkombëtar. Qeveria dhe Zyra e kryeministrit përkrahin, partneritetin multi-etnik të OJQ-

ve në Programin vullnetar promovues DMD".

Z. Henry McGowen III, Drejtor i Departamentit për të drejtat e njeriut dhe normave ligjore nga OSBE, theksoi se OSBE-ja do të vazhdojë të përkrah implementimin e qëllimeve nga Konventa mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.



**Z. Henry McGowen III, Drejtor i Departamentit për të drejtat e njeriut dhe normave ligjore nga OSBE**

Përfaqesuesi i shërbimit doganor theksoi përvojat pozitive të marra nga dita tradicionale " Dita E Doganës DMD" si një rastë të mirë për afrim, njoftim lidhur me kapacitetet profesionale të personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë diskutimit u theksua se papunësia në mesin e personave me aftësi të kufizuara është 99 % prandaj kjo kategori e qytetarëve konsiderohet si më e varfëra e shoqëris. Personat me aftësi të kufizuara ndihen të diskriminuar nga shoqëria.

Hilmnijeta Apuk, eksperte mbi të drejtat e këtyre personave, theksoi se vajzat dhe gratë shpesh herë janë të ballafaquara dhe në rrezik nga dhuna, keqpërdorimi, shfrytëzimi , eksploatimi, si në shtëpit e tyre ashtu edhe në shoqëri. Z.Apuk insistoi në kujdes të posaçëm ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe kërkoi që në të gjitha rastet e organizuara nga rrethi apo shoqëria prioritet t'u ipet interesit të këtyre fëmijëve. Gratë dhe vajzat tha ajo me që janë kategoria më e diskriminuar, ne si shoqëri duhet ndërmarrë masat adekuate për garantimin e lirive dhe të drejtave të tyre nga kjo Konventë. Apuk propozoi që të miratohet një ligj unik dhe gjithpërfshirës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në bazë të shembullit Amerikan, Ligji - ADA ( Americans with Disabilities Act).



Ceremonin e DMD dhe tryezën e rrumbullakët e donuan, Zyra Amerikane në Prishtinë dhe OSBE.

### Sqarim:

Në numrin e kaluar në janë përvjedhur disa gabime, andaj kërkohet ndjesë nga lexuesit. Në vazhdim teksti i përmirësuar:

1. Te Këshilli Nacional i Kosovës, duhet të jetë: "Qeveria e Kosovës, më 03.07.2006 ka themeluar Këshillin Nacional për personat me aftësi të kufizuara. Këshilli ka këtë përbërje:..." Dhe vazhdojnë emrat e anëtarëve të këshillit.

2. Artikulli "Kryeministri përkrah mediumet e pakicave" duhet të fillojë kështu: "Qeveria e Kosovës ka mbështetur financiarisht mediumet e pakicave, multi-etnike dhe grupeve tjera të pafavorizuara, përmes Fondit për Mbështetje të

Mediave të Minoriteteve, Multi-etnike dhe Grupeve Tjera të Pafavorizuara. Dy medime që u janë dedikuar grupeve të pafavorizuara, OJQ Little People of Kosova me revistën "Newspaper on the Rights of Persons with Disabilities of Kosova" dhe Shoqata e të Verbërve në Pejë me revistën akustike "Sfida jonë" kanë qenë dy përfituesit, nga gjithsejtë 11 medime, sa kanë përfituar nga ky fond.

Kryeministri i Kosovës, Agim Çeku ka bërë ndarjen e granteve dhe në këtë rast përfituesve dhe të pranishëmve në ndarjen e granteve, ju është drejtuar me mesazhin se Qeveria e Kosovës do të mbështesë në vazhdim mediumet e komuniteteve minoritare, multi-etnike dhe të grupeve të pafavorizuara. Kryeministri Çeku ju ka dëshiruar suksese dhe rezultate në punë gjithë përfituesve të granteve nga Fondi për Mbështetje të Mediave Minoritare, Multi-etnike dhe Grupeve Tjera të Pafavorizuara



Të brengosur për shkak të gjendjes së rëndë dhe formave të ndryshme të diskriminimit me të cilat ballafaqohen personat me aftësi të kufizuara, KB miratuan Konventën mbi të drejtat e këtyre personave. Me këtë rastë dua të theksoj se gratë dhe vajzat e kësaj kategorie më së shpeshti i janë të ekspozuara rezikut nga dhuna, lëndimi, keqpërdorimi, keqtrajtimi, eksploatimi, si në shtëpitë e tyre ashtu edhe jashtë. Konsiderohet se ndaj grave dhe vajzave zbatohet diskriminim i shumëllojshëm, andaj në këtë kuadër kërkohen masa për sigurimin e plotë e të barabartë të të drejtave dhe lirive të tyre. Shtetet nënshkruese duhet të ndërmarin të gjitha masat për t'u siguruar zhvillim të plotë, prosperitet dhe përfundim të grave, me qëllim të garantimit dhe realizimit të të drejtave dhe lirive elementare të garantuara

drejtave të njeriut me invaliditet.

Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet në tërësi t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë në bazë të barazisë me fëmijët tjerë. Duhet një kujdes i posaçëm tu kushtohet këtyre fëmijëve, ndërsa shteti në të gjitha aktivitetet e saj prioritet t'u kushtojë interesit të tyre.

Duke patur parasysh që kjo kategori e qytetarëve të Kosovës është më e varfëra duhet bërë përpjekje të pengohet ndikimi negativ i varfërisë në statusin e tyre.

Ta respektojmë dinjitetin e lindur, autonomin individuale të personit me aftësi të kufizuara, duke respektuar të drejtën e tyre për të vendosur për jetën dhe pavarësin e tyre.

Para nesh gjendet një përgjegjësi e përbashkët për implementimin e Konventës mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në kushtet në të cilat gjendet Kosova. Si të kyqen elemente nga Konventa në Legjislativin e Kosovës? Amandmane apo ligj i ri?

E juaja,  
Hilmnijeta Apuk

me Konventë. Poashtu, perspektiva gjinore duhet të inkorporohet në të gjitha përpjekjet për promovimin, realizimin dhe gëzimin e plotë të të

## KOSOVA NJE MJEDIS MIKPRITES PER TE GJITHE NJEREZIT

### INTERVISTE EKSKLUZIVE

Dr. Melissa Stone, është doktor i Filozofisë në Psikologjinë Sociale dhe punon si shefe e Njesisë Qendrore Këshillëdhënëse për të drejtat e Njeriut në Departamentin e Drejtave të Njeriut dhe Sundimin e Ligjit në OSBE, Misioni në Kosovë. Për veç kësaj, ajo këshillon Zyrën Këshillëdhënëse të Kryeministrit, për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabartë dhe Çështje Gjinore. Pesë vitet e saja të përvijës në Kosovë kanë kontribuar në zhvillimin dhe mbrojtjen e Drejtave të Njeriut në të gjitha ministritë e degës ekzekutive të qeverisë.

- *A mundë të thoni diçka me shumë sa i përket diskriminimit të femrave me aftësi të kufizuara?*

Ne dimë në fakt se femrat përjetojnë diskriminim më shumë se meshkujt, dhe se personat me aftësi të kufizuara përjetojnë më shumë diskriminim se sa njerëzit pa aftësi të kufizuar. Çka do të thotë se femrat me aftësi të kufizuar si mbas gjasave përjetojnë diskriminim nga dy anët. Në mënyrë të ngjashme, minoritetet femra me aftësi të kufizuar janë në rrezik të përjetimit të diskriminimi për tri arsye. Shumë faktorë shtesë mundë të ngritin rrezikun e personave të tillë nga diskriminimi, prej jetës në vendet rurale ku në mënyrë tipike kanë më pak qasja në shërbimet publike, të fillojmë nga një familje të lëndueshme për shkak të humbjeve gjatë konfliktit 1999.

- *A do të ishte Konventa për Mbrojtjen e Personave me Aftësi të Kufizuara sfidë për ligjin rregullativë në Kosovë?*

Konventa e re do të ofronte qartësi të re dhe definicion për obligimet e çfarëdo shteti nënshkrues për garantimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Në këtë moment, meqenëse konventa duhet të aprovohet nga Asambleja e Përgjithshme e KB dhe të ratifikohet nga shtetet specifike në mënyrë që të ketë efekt në këto shtete. Një sfidë për ti sjell dispozitat në ligjin e aplikuar është i ndërlidhur me faktin se statusi i Kosovës nuk është finalizuar ende. Prandaj, Kuvendi i Kosovës ende mund të ushtroj opinionin e vet për të adoptuar konventën si ligj të aplikuar vendor. Kjo tash më është bërë me instrumentet e tjera të Drejtave të Njeriut, si Konventën Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare. Në këtë rast, do të ishte më efektive nëse një ligj i tillë që miraton konventën e re mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe konkretisht definon obligimet e aktorëve specifik të Qeverisë së Kosovës në bazë të një plani të veprimit me buxhet specifik të destinuar për këtë përpjekje.

- *Çfarë mendoni për monitorimin e të Drejtave të Njeriut të personave me aftësi të kufizuara në nivelin shtetëror bazuar në Konventën për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?*

Kjo është ide shumë e mirë e cila mundë të përfshihet në planin e tillë të veprimit. Duke ditur se Kryeministri ka krijuar Njësitin e Drejtave të Njeriut në çdo ministri, monitorimi i nivelit qendror se si aktorët e qeverisë zbatojnë dispozitat e konventës së re

mundë ti caktohet saktësisht njësive të bazuara në ministri.

- *Cilat janë praktikat e mira nga vendet e zhvilluara dhe demokratike në mënyrë që të promovojnë dhe vetëdisojnë publikun për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?*

Ka shumë praktika të mira të cilat Kosova mundë ti miratoj. Një shembull i rëndësishëm është terminologjia të cilën e përdorim të gjithë për identifikimin e njerëzve të cilët kanë aftësi të kufizuara. Si qenie njerëzore të cilët mundë të kenë paaftësi, personi në tërsi nuk është i paaftë, në këtë mënyrë më mirë është të përdoret gjuha "person me aftësi të kufizuar" se sa "person i paaftë". Shembulli i dytë është programi që përqendrohet në aftësi, më mirë se në paaftësi të ndonjë personi.

Vetëm pse personi është në karrocë invalidësh apo ka dëmtim në të dëgjuar ose paaftësi që nga lindja nuk do të thotë se personi nuk ka fare ndonjë aftësi apo talent ose kapacitete. Programet si Shënimi i Ditëve të Personave me Aftësi të Kufizuar përqendrohet në zotësitë dhe aftësitë e personave të cilët kanë aftësi të kufizuar. Në shumë raste, personat e tillë kanë shumë për të ofruar, mundë të punojnë dhe të jenë produktive si kushdo tjetër në punë me pagesë.

- *Çfarë do të ishte porosia e juaj për lexuesit tanë?*

Aftësi e kufizuar është koncept relativ. Çdo person në planet ka anët e forta dhe të dobëta dhe personat me aftësi të kufizuar janë të ngjashëm. A konsiderohet personi i cili punon si inxhinier me aftësi të kufizuar nëse ai/ajo nuk mundë të vrapoj në garat maratonike në shteg dhe fushë? Përgjigjja është: natyrisht jo.



Dr. Melissa Stone

Duke konsideruar të drejtat e personave me aftësi të kufizuar, të gjithë do të ishim të mençur për të marrë qasje bazuar në anët e forta, të mos përqendrohemi në atë se çka nuk mundë të bëjnë, por më mirë është të përqendrohemi në atë se çfarë mundë të bëjnë njerëzit, çfarë kanë ata për të kontribuar dhe si mundë të marrin pjesë plotësisht në jetën publike. Vetëm me disa korrigjime dhe plotësime të vogla, sipas dispozitave të konventës së re, Kosova mundë të bëjë më shumë për të krijuar mjedis jetese e cila është më mikpritës për të gjithë njerëzit.

# SPORTET PARAOLIMPIKE

## 6 LLOJE GARASH - TENISI NE KARROCE



Tenisi në karrocë për herë të parë u paraqit në programin Paraolimpik në Barcelonë në vitin 1992. ky sport u themelua në SHBA më 1970 dhe vendosi e zhvilloi rregullat e lojës në mbarë botën. Garimi u përmbahet rregullave strikte tradicionale, shkathtësive dhe strategjisë së garuesve. Federata e Tenisit në karrocë është përfshirë në kuadër të Federatës ndërkombëtare të Tenisit.

Tenisi në karrocë luhet individualisht dhe në çifte nga dy lojtar në ekip. Lojrat Paraolimpike në tenis përbëjnë 6 lloje të ndryshme të garave:

- Meshkujt individualisht,
- Femrat individualisht
- Meshkujt në çifte
- Femrat në çifte
- Kvartet njëkahësh
- Kvartet i dyfishtë

Ekipi i Tenisit nga Amerika është kampioni botëror.



## LUNDRIMI



Lundrimi i adaptuar sportive është 235 lloje të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e cila është jashtë kualifikimit të miratuar për lundrim. Ky sport është paraqitur në programin paraolimpik në vitin 2005 dhe garat e para do të mbahen në Peking të Kinës në Paraolimpiadë më 2008.

Lundrimi i adaptuar është i hapur për meshkuj e femra dhe zhvillohet në katër anije njëkohsisht. Garimi zhvillohet në staza prej 1000 m.

Federata ndërkombëtare e lundrimit është organi që menaxhon me rregullat sportive për këtë disiplinë.



## XHUDO

Xhudo është lloji i sportit i cili paracakton performancat fizike dhe strategjike, aftësinë në kualitetin e prekjes, drejtpeshimin dhe ndjeshmërinë.

Garuesit duhet të përdorin teknika të ndryshme për ruajtjen e drejtpeshimit ndaj kundërshtarit. Ky sport është i hapur për të verbërit dhe ata me pamje të zvogluar si dhe atletët. Për këtë sport kompetente është Federata e Sportit Ndërkombëtar (IBSA) e përcjellur nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos (IJF). Ky sport është prezentuar në Lojrat Paraolimpike në Seul në vitin 1988, ndërsa në Athinë në vitin 2004 garuan mbi 30 shtete të botës në konkurrencën për femra dhe meshkuj.



# Intervistë me Gjylinaz Novobrdaliu-Kryesuese ne Divizionin e Ligjit Punës dhe Marëdhënjeve në Punë

**Shkalla e qytetërimit të secilës shoqëri matet në raportin ndaj personave me aftësi të kufizuara**

Në procedurë pune gjendet propozim ligji mbi rehabilitimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, të cilën e inicoi Ministria per pune dhe Mireqenje sociale,ky ishte shkas për të kontaktuar, z. Gjylinaze Novobrdaliu Gola, udhheqëse e Divizionit të Punës dhe mardhënjeve të punës që të na njoftojë se për cka në realitet bëhet fjalë.

- Me qëllim të afrimit me standardet e shteteve të zhvilluara, këtë vit shumë po flitet për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, mbi arsimimin etyre, punësimin, inkuadrimin e arsimimit inkluzivsi dhe pjesmarje në programet e punësimin. Eshtë fakt i pamohueshëm se personat me aftësi të kufizuara kanë njohuri , dëshirë për punë,janë ambicioz,mirëpo deri te punësimi arinë shumë vështirë. Ata gjatë punësimin nuk u kushtojnë harxhime më të mëdha punëdhënësve se personat tjerë.Jetojmë në situatë ku varfëria dhe papunësia në përqindje të madhe janë pasojë e luftës, kërkohet kohë për përmisimin e situatës ekzistuese. Këto rrethana edhe më shumë e vështërsojnë punësimin e kësaj grupe personash. Arsye kryesore është mungesa e ligjeve përkatëse që do ta rregullonin këtë materije e të cilët me futjen e obligimeve, por edhe të masave stimulative do të ndikonin në punëdhënësit që më shumë ti punësojnë personat me aftësi të kufizuara.

- Si të tejkalohet kjo gjendje a ka shoqëria ndonjë plan,z.Gjylinaze?

- 
- Qeveria ka paraparë ligjin mbi "Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin e personave me aftësi të kufizuara" në sategjin e project ligjit për vitin 2006. Divizioni i Ligjit te Punes dhe Marredhenjeve ne Pune në kuadër të Departamentit të Punës dhe Punësimin në Ministrin e Punës dhe Mbrojtjes Sociale, ka përpunuar propozimin e parë të këtij ligji i cili do të rregulloj të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në rehabilitimin profesional, punësim dhe punë në kushte të përgjithshme e të vecanta si dhe përgjegjësia e punëdhënësit poqese shkel normat e këtij ligji.

Meqë propozimi i parë ka përfunduar, duhet filluar me grupin tjetër punues qeveritar, e pas përfundimit të këtij grupi punues, Projekti i këtij Ligji

procedohet pas mbarimit të grupit të dytë Qeveritarë.Projek-Ligji për "Rehabilitimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Afëtësi të Kufizuar me memoradum shpjegues përcillët në Qeveri në procedurat e mëtejme.

*Mos po vonohet qeveria me miratimin e këtij ligji?*

- Po,prandaj, është koha që Qeveria ta shqyrtojë këtë ligj , miratojë dhe zbatojë në praktikë, do të shfrytëzohej energjija positive e personave me aftësi të kufizuara , aftësia profesionale , dëshira për punë, ndërkohë që do të zvoglohej papunësia dhe diskriminimi ndaj tyre. Nuk duhet harruar se nuk ka përparim në një shoqëri dhe nuk mund të ketë demokraci të mirfilltë pa respektimin e të drejtave të të gjitha kategorive të qytetarëve, theksoi z. Gjylinaze Novobrdaliu Gola.

*Porosia juaj për lexuesit tanë?*

- Nuk duhet haruar mendimin e vjetër, po citoj "Shkalla e qytetërimit të secilës shoqëri matet në raportin ndaj personave me aftësi të kufizuara"



## JAVA E NJERIUT ME SHKOP TE BARDHE

Më 15 tetor.solemnisht u hapë "Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bardhë". Në manifestimin disa ditë morrën pjesë numër i madh i personave të verbër dhe atyre me pamje të dobësuar nga mbarë Kosova, përfaqësues të qeveris si dhe lider të shumtë të OJQ-ve që merren me çështjet e personave me aftësi të kufizuara.

Të pranishmit i përshëndeti Kryetari i Shoqatës së të verbërve të Kosovës, z. Bujar Kadriu i cili porosity, qeveritarët që t'a sjellin, Ligjin mbi të verbërit, sikurse shtetet tjera demokratike.

Drejtori i Zyrës për qeverisje të mire, z.Habit Hajredini, theksoi rëndësin dhe nevojën e përkrahjes së personave me aftësi të kufizuara dhe qeveria tha ai me këtë rastë në çdo aspect do të përkrah këtë kategori të qytetarëve.

Të njëjtën ditë pas ceremonies z. Ejup Rashica, Kryetar i shoqatës ndërkomunale të të verbërve nga Prishtina me bashkpuntorët e tij organizoi një takim në të cilin u diskutua mbi problemet dhe barrierat me të cilat ballafaqohen të verbërit dhe personat me pamje të dobësuar. Pronari i Hotel "Prishtina" shtroi darkë falas për 100 persona të verbër.

Gjatë javës kjo shoqatë organizoi një takim me shefin e Policis z. Sheremet Ahmeti me të cilin diskutuan mbi mundësit e komunikimit në komunikacion.U theksua nevoja për semafor të zëshëm për sigurin më të madhe si dhe rëndësia e shkopit të bardhë për identifikimin e tyre më të lehtë.U bisedua poashtu mbi mundësit e punësimin të të verbërve në Polici. z Sheremet Ahmeti premtoi se do të përpiqet të sigurojë kushte më të mira për siguri më të madhe dhe mundësi punësimi.

Në një takim të veçantë, kryetari i komunës z. Ismet Beqiri u premtoi ndihmë si dhe vendosje të më shumë semaforëve të zëshëm nëpër qytete dhe një mbështetje financiare nga komuna e Prishtinës.

"Java ndërkombëtare e njeriut me shkop të bardhë" u përcoll me manifestime të shumilleshme në mbarë Kosovën.



# KONVENTA mbi të DREJTAT e PERSONAVE me AFTËSI të KUFIZUARA

## Pse Konventë?

Pse kemi nevojë për një konventë të veçantë për personat me aftësi të kufizuara? A nuk i gëzojnë ata të drejtat e njëjta si gjithë të tjerët?

Të drejtat e radhitura në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, në një botë të përkryer, do të mjaftonin për të mbrojtur secilin. Por në praktikë, grupe të caktuara, siç janë gratë, fëmijët dhe refugjatët janë gjetur në një gjendje më të keqe se grupet e tjera dhe ekzistojnë konventa ndërkombëtare në fuqi për të mbrojtur dhe kultivuar të drejtat e njeriut të këtyre grupeve. Kështu, 650 milion njerëz jetojnë me aftësi të kufizuara rreth 10 % e popullatës botërore kanë mungesë të mundësive që i gëzon popullata e përgjithshme. Ata përballen me një varg të pengesave fizike dhe sociale si:



Pengesat për të realizuar të drejtën për shkollim;

Pengesat për të siguruar vend pune, edhe në rast kur ata janë të kualifikuar si duhet;

Pengesat për qasje në informata;

Pengesat për të siguruar shërbime të përshtatshme mjekësore;

Pengesat për të qarkulluar përrreth; Pengesat për t'u 'përshtatur' dhe për të qenë të pranueshëm.

## Çfarë mbulon konventa?

Qëllimi i konventës është të kultivojë, të mbrojë dhe të sigurojë gëzim të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave njerëzore nga personat me aftësi të kufizuara. Ajo

mbulon një numër të fushave kyçe si qasja, lëvizshmëria personale, shëndetësia, shkollimi, punësimi, veshmbathje e trajnimi dhe rehabilitimi, pjesëmarrja në jetën politike, barazia dhe jodiskriminimi. Konventa shënon një ndryshim në botëkuptimet për paaftësitë nga të qenit një shqetësim për mirëqenien shoqërore në çështje të të drejtave të njeriut, që e pranon se barrierat shoqërore dhe paragjykimet vetvetiu shkaktojnë paaftësi.

## A krijon kjo konventë të drejta të reja?

Jo. Konventa nuk krijon ndonjë të drejtë të re ose nuk jep të drejta të reja. Por shprehë të drejtat ekzistuese dhe trajton nevojat dhe gjendjen e personave me aftësi të kufizuara.

## A po funksionon legjislacioni ekzistues?

Disa vende kanë dekretuar legjislacione gjithëpërfshirëse në këtë drejtim, por shumë vende nuk e kanë bërë këtë. Për shkak të praktikave diskriminuese, personat me aftësi të kufizuara janë të shtyrë të jetojnë në hije dhe margjina të shoqërisë, dhe si rezultat i kësaj të drejtat e tyre nuk vërehen. Një standard ndërkombëtar, me detyrime ligjore është i nevojshëm për të siguruar se të drejtat e personave me aftësi të kufizuara të garantohen kudo.

Rregullat Standarde të KB mbi Mundësi të Barabarta për Personat me Aftësi të Kufizuara (1993) kanë shërbyer si model i legjislacionit për një numër të vendeve. Ato ofrojnë udhëzime për politikën në lidhje me kultivimin e mundësive të barabarta për personat me aftësi të kufizuara që i gëzojnë të tjerët. Megjithatë, Rregullat Standarde nuk janë një instrument detyrues dhe aktivistët për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara theksojnë se nuk mund të ketë obligime të zbatueshme pa një konventë.

## Çfarë konkretisht do të bënte konventa?

Me ratifikimin e konventës, një vend pranon obligimet ligjore të dala nga marrëveshja (traktati) duke miratuar implementimin e legjislacionet menjëherë pas futjes së konventës në fuqi.

Traktate të tjera mbi të drejtat e njeriut, si konventat mbi të drejtat e fëmijëve dhe grave, kanë pasur një efekt madhor në trajtimin e shkeljeve të të drejtave.

## A është realiste të mendohet se një konventë do të përmirësojë jetën e personave me aftësi të kufizuara?

Gjatë historisë, personat me aftësi të kufizuara janë parë si individë që kërkojnë mbrojtje shoqërore dhe ngjallin keqardhje më shumë se respekt. Kjo konventë do të jetë një hap madhor drejt ndryshimit të botëkuptimeve për paaftësitë dhe sigurimit se shoqëritë e pranojnë se të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësinë për të jetuar jetët e tyre me mundësi të plota, çfarëdo qofshin ato.

## Si do të monitorohet kjo konventë në nivel ndërkombëtar?

Aktivistët për mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara shpresojnë se konventa po ashtu mund të ndihmojë ndërtimin e një rrjeti global të aktivistëve për të monitoruar progresin e të drejtave të njeriut.

## Kush është person me aftësi të kufizuar?

Paftësitë mund të jenë fizike, mentale dhe pengesa shqisash si verbëria, shurdhëria, lëvizshmëri e vështirësuar, pengesa në zhvillim dhe intelektuale. Disa njerëz vuajnë nga më shumë se një paftësi dhe shumë prej tyre, nëse jo shumica, do të vuajnë nga një paftësi në një kohë të jetës së tyre për shkak të lëndimeve fizike, sëmundjes ose plakjes.

## A do të krijojë kjo konventë obligime për Shtetet?



Po. Shtetet do të jenë të obliguara të ndërmarrin masa që kultivojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara pa kurrfarë diskriminimi. Këto masa përfshijnë miratimin e legjislacionit kundër diskriminimit, eliminimin e ligjeve dhe praktikave diskriminuese ndaj personave me aftësi të kufizuara, dhe marrjen parasysh të personave me aftësi të kufizuara kur të miratohen politikat dhe programet e reja. Masat e tjera përfshijnë sigurimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në shërbime, të mira dhe objekte.

## A ka ndonjë kuptim ekonomik për vendet që miratojnë konventën?

Po. Ndonëse është e pamundur t'i vihet një çmim të drejtave elementare të njeriut, del në pah se në të vërtetë është mjaft ekonomike që të sigurohet se personat me aftësi të kufizuara të jenë në gjendje të jetojnë me potencialin e tyre të plotë.

## Sa do të kushtojë zbatimi?

Konventa bën thirrje për 'realizim progresiv' të shumicës së dispozitave të tyre, në linjë me resurset e vendeve individuale. Disa hapa do të kërkojnë para dhe për vendet ku burimet janë të pakta, shpresohet se asistencë ndërkombëtare që i ka neglizhuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara do të ndihmojë.

Bërja e ndryshimeve në linjë me konventën do të jetë e dobishme jo vetëm për personat me aftësi të kufizuara, por edhe për të tjerët në përgjithësi. Ashensorët dhe shkallët e lëvizshme, ofrojnë më shumë mundësi për të gjithë.

Dizajnimi i ndryshimeve të nevojshme për të jetësuar konventën me kohë do të prodhojnë edhe ide të reja dhe shpikje që do të përmirësojnë jetën për të gjithë njerëzit, jo vetëm për personat me aftësi të kufizuara.

**A është shtrenjtë ndërtesat të bëhen të qasshme?**

Me kohë, ndërtimet e reja duhet të inkorporojnë modele që kanë parasysh nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Në studimet e tyre, Banka Botërore ka arritur në përfundim se

kostoja e ndërtimeve të këtyre veçorive gjatë ndërtimeve është minimale. Është vlerësuar se bërja e ndërtesave të qasshme, shton më pak se një përqind çmimin e ndërtimeve.

**Çfarë po humb shoqëria?**

Një sfond më të gjerë talentesh. Personat me aftësi të kufizuara mund të kontribuojnë në shumë fusha të ekspertizës, shkathtësive dhe talentit. Përderisa personat me aftësi të kufizuara përballen me shkallë më të lartë të papunësisë sesa pjesa tjetër e popullatës, thuajse

në çdo vend, studimet tregojnë se performanca në punë nga personat me aftësi të kufizuara është po aq e mirë nëse jo edhe më e mirë, sesa e popullatës së përgjithshme. Shkalla e lartë e mbajtjes e më pak e mungesa kanë më shumë se kompensuar drojën se është shumë e shtrenjtë të akomodohen nevojat e personave me aftësi të kufizuara në vende të punës. Për më tepër, frika se pranimit i personave me aftësi të kufizuara i shton shumë shpenzimet e punëdhënësit është e fryrë. Një

studim i vitit 2003 në SHBA nxori në pah se gati tri të katërtat e punëdhënësve raportuan se personat me aftësi të kufizuara nuk kishin nevojë për ndonjë akomodim special.

H. Apuk,

Në përgaditjen e materialit kanë bashkëpunuar, z. Habit Hajredini, Drejtor i Zyrës për Qeverisje të Mirë, Zyra e Kryeministrit të Kosovës dhe z. Dijana Toska, anëtare e Bordit Little People of Kosova që nga themelimi.

# SPORTI KOSOVAR PËR TË VERBËR NË - RRUGË TË MBARË

Seminar treditor për avancimin e sportit të gollballit në Kosovë

Peja ishte mikpritëse e seminarit treditor që u organizua nga Federata e Sporteve për të verbër të Kosovës dhe ku ligjërues ishin ekspertet më të njohur të IBSA (Internacional Blind Sports Federatio ).

Vizita e kryetarit të Federatës së sporteve për të verbër të Kosovës z. Daut Tishuki në Belgjikë korrikun e këtij viti i parapriu këtij seminarit mjaft të rëndësishëm për avancimin e sporteve për të verbër në përgjithësi e në veçanti të gollballit.

Seminari ishte i udhëhequr nga :

- Rob 't Hart (Holand)
- Joke 't Hart (Holand )
- Knut Kursawe (Gjermani )
- Colette Altwasser (Gjermani )

- Tom Janssen ( Belgjik)
- Jelle Mols ( Belgjik)
- Walter Tielemans ( Belgjik)

Në këtë seminar morrën pjesë trajnerët dhe kapitenët e 7 ekipeve të gollballit të Kosovës si dhe 15 kandidatët për refer të lojës së gollballit.

Seminari ishte i ndarë në tri grupe pune dhe ate për njohjen me rregullat më të reja të lojës së gollballit (IBSA, 2006 ) , grupi i aftësimit dhe licencimit të referëve e zyrtarëve dhe grupi i aftësimit të trajnerëve dhe kapitenëve të ekipeve.

Pas tri ditësh pune efektive u licencuan 15 referë dhe u aftësuan trajnerët dhe kapitenët e ekipeve.

Seminari ishte një hap bazë që i paraprin fillimit të Ligës së Gollballit të Kosovës dhe me frytet e këtij seminarit sporti për të verbër i Kosovës

është më afër pranimit në Federatën Europiane të sporteve për të verbër.

Këtë seminar e sponsoruan: Departamenti i sportit i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe çështjeve jorezidenciale, Ministria Flamane e sportit dhe Korporata Dukagjini.



## OJQ “Hendifer” nga Ferizaji

OJQ “Hendifer” nga Ferizaji ( partner nga Programi Promovues Vullnetar DMD) organizoi defile në qendër të qytetit në të cilën morrën pjesë mbi 250 persona me aftësi të kufizuara, ndërkohë që mbi një mijë qytetarë të tjerë përcollën këtë manifestim jo të zakonshëm.



Xhevat Islami dhe Fazile Bingu, organizator dhe coordinator të fushatës, “Tetori për DMD” njoftuan se deri më tani kanë punësuar 45 persona, ndërsa këto ditë kanë kryer të gjitha bisedat dhe pritjet punën një ditore ta fillojnë edhe 112 persona të tjerë, ( të verbër, shurdhmemec, në karrocë, me lëvizje të vështësuar, me probleme mentale), në institucione të ndryshme shoqërore e private.

“Mbesim me shpresë se shoqëria kosovare do t'i integrojë personat me aftësi të kufizuara më shumë në mesin e saj, ndërsa ne do të mund t'i zhvillojmë aftësit tona profesionale përmes partneritetit tonë në Programin Vullnetar DMD” - shprehet Xhevat Islami, njëri nga koordinorët e këtij Programi.

## MUAJI I PUNËSIMIT



## DOGANA - NJË DITË BARAZIE QYTETARE

Partneriteti mes OJQ-ve nga Programi Promovues Vullnetar DMD (Disability Mentoring Day) nga Kosova, organizoi fushatë të punësimit njëditor për personat me aftësi të kufizuara, si pjesë e fushatës ndërkombëtare DMD e cila rrënjët i ka nga Amerika dhe sot zbatohet në tërë botën.

Në kuadër të fushatës DMD Dogana e Kosovës në bashkëpunim me OJQ “Little People of Kosova” organizoi më 16 tetor punësim njëditor për 45 persona me aftësi të kufizuara, nëpër zyrat e saj në mbarë vendin dhe simbolikisht i pagoi me nga 10 euro. Këtë gjest të doganës duhet ta ndjekin edhe institucionet tjera, organizatat, shërbimet e sektori privat.

**RESPEKTONI:**

**INTEGRITET**

**DALLIMET**

**DINJITET**

**TALENTËT E RINJ**

**PA DISKRIMINIM**

**LUFTIMI I DHUNËS**



[www.lpkosova.com](http://www.lpkosova.com)